

# Parajsja Fasonerike në Krizë!

**RAPORT MONITORIMI**

Tetor-Dhjetor 2022

QENDRESA  
QYTETARE



**NED**

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)



AUTOR

**VALMIRA HOXHA**

# Parajsa Fasonerike në Krizë!

## Përmbajtja:

Hyrje	3
Sektori fason në Shqipëri	4
Fuqia punëtore, elementi i suksesit të fasonerive	5
Kriza për punëtorë	6
Kushtet e një punonjësi fasonerie	7
Përfundime:	9
Rekomandime:	10
Referencat:	11

## Hyrje

Spektori i fasonerisë është një ndër sektoret me përhapje më të gjerë dhe fuqi më të madhe punëtore në vendin tonë. Gjatë 20 viteve të fundit biznesi fason ka pësuar një zhvillim të vullshëm. Në Shqipëri operojnë më shumë se 700 biznese që bëjnë pjesë në këtë industri me një numër tepër të lartë punonjësish ku mesatarisht secili biznes ka të punësuar rreth 250 punonjës. Kjo fuqi punëtore është elementi kryesor i zhvillimit që sektori ka.

Nga ngjarjet e ndodhura viteve të fundit, nisur nga situata e tërmetit, pandemisë, mbylljet e bizneseve, situata pas-pandemisë, lufta në Ukrainë e pasojat në kosto më të larta importi dhe së fundmi kriza për punëtorë ka bërë që për fasonerinë këto periudha të jenë mjaft sfiduese. Në këto momente kostot në rritje të importit dhe kriza e fuqisë punëtore janë problematikat më të mëdha për këtë industri. Kërkesa për punonjës qëndron e lartë nga ana e subjekteve ndërkohë që oferta apo përgjigjja e punonjësve nuk duket optimiste për këtë sektor.

Tërheqja nga ana e punonjësve potencial për fasoneritë gjen shkak në mungesën e kushteve, e pohuar kjo dhe nga perfaqësues të sektorit. Rastet evidentuese të shkeljeve kanë qenë të shumta ndër vite, por shkalla e reagshmërisë nga kompanitë apo institucionet ka qenë e pakët. Tendenca qëndron në izolimin e rasteve, veçanërisht kur bëhet fjalë për pasojat që mungesa e kushteve ka sjellur në mjedisin e punës, qofshin ato shëndetësore, higjienike apo ekonomike. Ndërkohë që flitet për zhvillim të industrisë, të ardhura rekord të gjeneruara në anën e punonjësve vazhdojnë diskutimet për kushtet minimale dhe të cilat i garantohen dhe i mbrohen me ligj.



## Sektori fason në Shqipëri

Zhvendosja e punës së krahut (fason) në vendet në zhvillim apo me kosto të ulët për fuqi punëtore njihet si një ndër strategjitë më të përdorura logjistike të kompanive të mëdha. Në rastin e Shqipërisë, kjo ishte një ndër arsyt kryesore që çoi në zhvillimin e sektorit fason, por jo e vetmja. Pozicioni gjeografik që Shqipëria mban është një atraksion mjaft i madh për investitorët potencial të huaj dhe shqipëtar duke mundësuar fasilitetet për tregtimin dhe eksportimin e mallrave apo produkteve në Europë e më gjerë. Oferta për fuqi punëtore ishte një element tjetër bindës për investitorët në lidhje me hapjen e bizneseve të fasonerisë në Shqipëri.

Sipas të dhënave statistikore nga INSTAT në vendin tonë gjatë vitit 2021 kanë qenë aktive 97 biznese të eksportit të mallrave dhe produkteve në tregtinë e jashtme me mbi 250 punëtorë. Nga viti 2013 që datojnë dhe të dhënat, numri mesatar i ndërmarrjeve me mbi 250 të punësuar në këtë sektor qëndron mbi 98 ndërmarrje. Janë më shumë se 700 biznese që bëjnë pjesë në Dhomën Kombëtare të Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpuce në Shqipëri. Hapja e bizneseve të tilla dhe stabilizimi në ekonominë shqiptare ka çuar në krijimin e një tregu më të konsoliduar dhe më të sigurt në pamje të parë për ofruesit e fuqisë punëtore.

Rritja dhe zhvillimi i fasonerive ka ndihmuar jo pak edhe ekonominë vendase. Të ardhurat neto nga bizneset fason për 6 mujorin e parë të vitit 2022 kanë tejkaluar edhe ato të industrisë së turizmit. Nga të dhënat e publikuara të BSH dhe revistës Monitor vemë re se ky zë është kontribuesi i dytë më i madh neto mes zërave të llogarisë korrente, ku vendin e parë zënë remitancat. Në zërin e shërbimeve për përpunimin e inuteve fizike të zotëruara nga të tjerët u arritën 340 milionë euro të ardhura neto, 36% më shumë se 6 mujori i parë 2021. Kjo është vlera më e lartë e të ardhurave neto e arritur ndonjëherë nga fasoneria në Shqipëri.



Parajsa  
Fasonerike  
në Krizë!

Grafiku më lart paraqet tendencën\* e të ardhurave të perftuara nga fasoneria në intervalin kohor 2008-2022.

Krahas kontributit në zhvillimin e ekonomisë së vendin dhe numrit të lartë të të punësuarve, sektori fason më së shumti ka qenë në qendër të vëmendjes për problematikat e hasura me të punësuarit. Rastet e pakënaqësive të punonjësve, protestave ndër vite për kushtet e munguara, ekspozimin e skandaleve që çënonin të drejtat e punonjësve apo kriza dhe efektet e pasuara nga pandemia kanë qenë çeshtjet kryesore mbi të cilat është lidhur biznesi fason për publikun.

Akuzat kryesore kanë qëndruar për mosrespektimin dhe shkeljen e normave të vendosura në Kodin e Punës. Në shumë prej fabrikave që operojnë në fushën e tekstilit dhe këpucëve në Shqipëri, janë evidentuar raste punësimi të personave minore, paga nën minimalen, thyerje të Kodit përsa i përket siguracioneve apo orëve plus. Pavarësisht reagimit qytetar apo mediatik rastet e marrjeve të masave për eliminimin ose reduktimin e këtyre problematikave nga ana e qeverisë dhe institucioneve përkatëse kanë qenë pothuajse inekzistente në raport me rastet e pafundme të shkeljeve.

## Fuqia punëtore, elementi i suksesit të fasonerive

Për një biznes të madh, burimet njerëzore janë gjithmonë një ndër pikat kyçe që përkufizojnë suksesin apo dështimin e tij. Në rastin e bizneseve fason, forca punëtore në tërësi mbart peshën më të madhe të mirëfunksionimit të biznesit. Keto kompani janë të ndërtuara dhe të projektuara nga ana funksionale me bazë fuqinë e punës së dorës.

Industria fason në mbarë botën lidhet me një kërkesë të lartë për fuqi punëtore. Fokusi qëndron në biznese që çdo ditë e më tepër drejtohen në tregtimin e produkteve më avantazh konkurrues kryesor çmimin, gjë që në mënyrë imediate duhet të reflektohet në ulje të kostove në minimum. Në kushte normale kjo përkon me kosto tepër të larta për bizneset e përfshira në industri, por strategjia e pozicionimit të fabrikave në vende në zhvillim apo me ekonomi të dobët, ku sa më të ulëta të jenë të ardhurat për frymë aq më e lartë do jetë oferta për punë, sjell reduktimin e kostove ndjeshëm për industrinë e fasonerisë. Operimi i fabrikave pranë vendeve ku ka një numër të lartë papunësie afatgjatë, duke veçuar gratë dhe shtresat e margjinalizuara; probleme apo "hapsira boshe" me ekzekutimin e legjislacionit përsa i përket të drejtave të punonjësve i jep mundësinë që të eliminojnë kosto të lidhura me infrastrukturën, mirëmbajtje, kujdesin e nevojshëm ndaj punonjësve, pagimin e detyrimeve për

Parajsa  
Fasonerike  
në Krizë!


# Parajsa Fasonerike në Krizë!

oraret shtesë e deri në sigurimin e tyre. Mungesa e informacionit dhe nevoja e një pune të qëndrueshme për të siguruar të ardhurat minimale në familje bën që kjo kategori punonjësish shpeshherë të dakortësohet me kushte jashtë standarteve, duke i shndërruar në target-grupin më të preferuarin për drejtuesit në këtë sektor dhe çelësin e lulëzimit të fasonerive e gjenerimit të shifrave rekord të ardhurash.

## Kriza për punëtorë

Një ndër fenomenet që është vënë re kohëve të fundit është kriza për punëtorë që biznese të shumtë po hasin në Shqipëri. Një fenomen i parashikuar nga ekspertët e ekonomisë por dhe të tregut të punës si rrjedhojë e disa faktorëve social dhe politiko-ekonomik të ndodhur gjatë viteve të fundit. Sektori i cili po vuan më së shumti nga kjo krizë është fasoneria, shërbimet tek baret e restorantet.

Të dhënat nga Buletini Statistikor për vitin 2021 nga AKPA, tregojnë një disbalancë midis kërkesë-ofertës për punë duke veçuar industrinë përpunuese. Gjatë këtij viti janë shpallur 24 965 vende të lira punë dhe 9 237 i përkasin industrisë përpunuese, ndërkohë që numri i personavë të regjistruar pranë Zyrave të punësimit si punëkërkues në fund të po këtij viti ka qenë 70 646. Një tendencë tjetër ka qenë rritja e pësuar e kërkesës në kategoritë e zejtarëve dhe zanatçinjëve dhe profesioneve elementare sipas kategorive profesionale. Sipas aktiviteteve ekonomike, informacioni dhe komunikacioni, shërbimet administrative dhe mbështetëse, aktivitete të tjera shërbimi kanë pësuar rënie, ndërsa industria përpunuese, ndërtimi, transporti, furnizimi me ujë dhe energji elektrike rritje.



Vendet e lira të punës të shpallura sipas aktivitetit ekonomik  
Burimi:AKPA

## Parajsa Fasonerike në Krizë!

Mungesa e punëtorëve dhe mosplotësimi i kërkesës për këtë kategori ka bërë që mjaft biznese fason të shkojnë drejt kërkesës për punonjës të huaj. Për vitin 2021, janë 5 034 shtetas të huaj (ose 1,693 më shumë se një vit më parë) të pajisur me Leje Pune dhe Vërtetime Deklarimi për Punësim. Pjesa më e madhe e Lejeve dhe Vërtetimeve (rreth 43%) janë në rajonin e Tiranës, 13% nga Rajoni Lezhë dhe 13% nga Rajoni Durrës. Afërsisht 90% e tyre janë pajisur me leje të tipit A/P punëmarres. Në shpërndarjen e punonjësve të huaj për aktivitetet ekonomike, mbizotëron Industria Përpunuese me 15%, Ndërtimi me 12% dhe Bujqësia me 11%.

Të dhënat e fundit figurojnë para 2 vitesh, ndërkohë që kërkesa për punëtorë në profilet e lartëpërmendur ka pësuar rritje si rrjedhojë e krizës së thelluar për këto sektorë. Një element tjetër i cili nuk merret në shqyrtim në raportet e publikuara është tendenca në rritje e të huajve që punojnë joformalisht në vend.

Thellimin e krizës për punëtorë e kanë mbështetur dhe përfaqësues të sektorit fason, duke u shprehur se ky sektor po përballet më vështirësi të mëdha pas pandemisë dhe luftës në Ukrainë. Ato shprehen se sektori është dëmtuar dhe fitimet kanë rënë si pasojë e kësaj gjëndjeje. Kostot për prodhim dhe lëndë të parë janë rritur ndjeshëm dhe mungesa e forcës punëtore rrit edhe më kostot e prodhimit. Edvin Prença, përfaqësues i Shoqatës ProExport evidentoi që tregu momentalisht (tetor 2022) kishte nevojë për 25 000 punëtorë. Përpara një kërkesë të publikuar haptazi nga sektori fason që përkon me numrin e thuajse të gjithë të regjistruarve në Zyrat e Punës na bën të kuptojmë që ka një sarë elementësh të rëndësishëm që impaktojnë hendekun e krijuar dhe krizën për punëtorë.

## Kushtet e një punonjësi fasonerie

Situata në tregun e punës paraqet një hendek dhe disbalancë ndërmjet kërkesë-ofertës për punë. Industria e përpunimit krahas zgjerimit gjeografik dhe zhvillimit ekonomik të vendit, po paraqet një kërkesë më të zgjeruar në treg për fuqi punëtore. Në anën tjetër, pranë Zyrate të Punës dhe Agjensisë Kombëtare të Punësimit, regjistrat e punëkerkuesve dhe të individëve të papunë (afatgjatë) vazhdojnë të jenë në numra tepër të mëdhenj. E pranuar nga përfaqësues të sektorit, si edhe vetë punëtorë pranë këtyre ndërmarrjeve, arsyeja kryesore vijon të ngelet mungesa e kushteve të përshtatshme, mosrespektimi i të drejtave të punonjësve apo pagat nën minimalen.

# Parajsa Fasonerike në Krizë!

Të drejtat e punëtoreve njihen dhe mbrohen me ligj sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe Kodit të Punës. Cënimi i këtyre të drejtave dhe moplotësimi i tyre nga punëmarrësi është reflektuar vitet e fundit në krizën e fasonerisë për punëtorë. Në rastet e evidentuara në media, nga sindikatat, punonjësit apo edhe organizata që mbrojnë të drejtat e grave kemi të bëjmë më mungesën e kushteve bazë për një punë dinjitoze. Raste helmimi punonjësish nga mungesa e kushteve higjienike dhe lëndëve me të cilat punohet, aksidentimi dhe përpjekja për t'i mbuluar të tilla ndodhi nga syri i publikut apo edhe policisë. Fabrika që punësojnë minorenë, madje edhe me orare të zgjatura apo probleme me sigurimet.

Lajmet, kronikat apo denoncimet publike që punonjësit bëjnë qoftë në rrugë pranë subjekteve apo në media është vështirë t'i perceptosh si të vërteta dhe pjesë e realitetit ku jetojmë çdo ditë. është e vështirë të konceptosh se si në një ndërmarrje me mbi 300 punëtorë në vend të mjekut të përgjithshëm i cili duhet të jetë në bazë të Kodit të Punës, punonjësit kanë veteriner. Në 2022 kemi akoma raste të helmimi në ambientin e punës si pasoje e kushteve higjienike. Ngjarje jo e paprecedentë për fasoneritë në Shqipëri, ku edhe pas hetimi, ndërmarrja mbyllet për 5 ditë dhe pastaj vazhdon aktivitetin e saj normal.

Larg realitetit të konceptuar është edhe rasti i fasonerisë në Bilisht, ku kryetarja e sindikatës ishte shkarkuar nga puna për shkak se punëtorëve po i përgjysmohej paga. Ky rast është jo vetëm i padrejtë, por edhe shkel Nenin 10 të Ligjit për Sindikatat (Ligj Nr.7516, datë 7.10.1991) ku thuhet se: *"Anëtaresia në sindikatë dhe aktivizimi në veprimtarinë sindikaliste, nuk sjell asnjë kufizim të të drejtave të punonjësit dhe **nuk mund të shërbejë si shkak që punëdhënësit ta largojë atë nga puna**".* Përpara prononcimit për mediat, pronari i subjektit shprehet se arsyet përkonin me reduktimin e stafit për shkak të rritjeve të kostove, ndërkohë që punonjësit protestonin për të kundërtën. Bërja e këtij rasti publik duket se ka tërhequr vëmendjen e vetë ministres së Financave dhe Ekonomisë, e cila vizitoi subjektin dhe në diskutim dy-palësh u dakortua mbi hartimin dhe firmosjen e kontratave të tjera të punës në përputhje me Kodin e Punës. Pavarësisht hartimit të kontratave të reja sipas përcaktimeve ligjore, nuk kemi informacion nëse janë marrë masa për keto shkelje.

Element shqetësues për këtë kategori kanë qenë thuajse gjithmonë pagat e ulëta. Me ndryshimet e fundit, paga minimale në vend është 34 000 lekë të reja, një ndër pagat më të ulëta jo vetëm në rajon por edhe Europë sipas Eurostat. Në këto fabrika edhe respektimi i vendimit të fundit mbi pagat lë vend për diskutim. Përfaqësuesit e punonjësve apo sindikata në qytete të ndryshme shpeshherë kanë ngritur zërin për problematika të tilla. Sipas tyre qeveria duhet që të



veprojë, sepse ato nuk kanë asnjë fuqi ligjore që të ndryshojnë këtë situatë, madje në fabrika atyre nuk ju lejohet të hynë.

Inspektimet e fundit që janë zhvilluar pranë këtyre subjekteve duket se kanë qenë gjatë periudhës së pandemisë, madje edhe atëherë si pasojë e ekspozimit të rasteve ku punonjësit punonin jashtë masave të publikuara anti-covid. Përfundimisht, rasti i Bilishtit apo takimeve të Znj. Ministre me përfaqësues të fasonerive në subjektet përkatëse. Nuk dihet nëse janë zhvilluar kontrole të tjera, qoftë nga Inspektoriat i Shëndetësisë apo Inspektoriat i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për shkeljet e bëra, evidentimet e publikuara, protestat apo qoftë edhe kontrole rutinë. Të panjohura ngelen edhe masat administrative që janë marrë ndaj këtyre subjekteve pas periudhës së pandemisë. Ajo çfarë dihet është që individët po e shohin gjithnjë e më larg idenë e të punuarit në një fasoneri, kundrejt edhe nevojës jetike për punë dhe për të mbajtur një familje. Problemi dhe shqetësimi më i madh qëndron për atë kategori e cila nuk ka mundësi zgjedhjeje dhe opsiioni i vetëm është fasoneria.

## Përfundime:

- Sektori fason po kalon një ndër periudhat më të vështira. Krahas rritjeve të kostos së importit si pasojë e luftës në Ukrainë, një ndër sfidat më të forta që po përballë është kriza për punëtorë dhe konkurrenca nga rajoni.
- Në fundin e vitit 2022, industria e përpunimit e veçanërisht sektori fason ka qenë sektori më kontributiv më të lartë të të ardhurave neto në ekonominë e vendit.
- Tregu i punës në Shqipëri momentalisht po përballë me një hendek midis kërkesë-ofertës, krahas një norme të lartë papunësie dhe punëkërkuesish në Zyrat e Punës, oferta e paraqitur nga ana e punëdhënësve shprehur në vendet e lira të punës regjistruar në Agjensinë Kombëtare të Punës ka pësuar rritje.
- Kushtet e munguara dhe të drejtat e cënuara të punonjësve në fasoneritë në vend janë arsyeja kryesore e krizës për punëtorë që po haset sektori fason 3 viteve të fundit.
- Sindikatat duhet të jenë zëri dhe mbështjetja më e fortë për këtë profil pune lidhur me problematikat e shumta dhe fuqinë që i jep ligji. Pavarësisht kësaj, sindikatat veçanërisht në qytete të vogla ndihen të pafuqishme dhe mundësitë për të vepruar janë të pakta. Problemi vjen e bëhet më serioz kur kemi të bëjmë me mungesën e përfaqësive dhe legjitimitimin e tyre në sindikata.

## Rekomandime:

- Kontrollat periodike nga Inspektorati i Shëndetësisë dhe Inspektorati i Punës dhe Sherbimeve Shoqërore mbi kushtet në të gjitha subjektet e fasonerive që veprojnë në vend. Kontrolli i detajuar mbi standartet dhe kushtet bazë të punës.
- Marrja e masave reale ndëshkuese kundrejt subjekteve shkelëse të Kodit të Punës, por edhe moszbatimit të standarteve bazë të higjenes, shëndetësisë, mbrojtjes së jetës në rast aksidenti dhe paga nën minimalen.
- Promovimi dhe lancimi i pozicioneve të hapura të punës në këtë sektor nga Zyrat e Punës të bëhet vetëm pas kontrollit të detajuar të standarteve dhe kushteve të punës.
- Ngritja, njohja dhe fuqizimi i sindikatave të punonjësve të fasonerive në të gjitha qytetet ku operojnë ndërmarrje të tilla. Qëllimi bazë: informimi i punonjësve mbi të drejtat e tyre si dhe evidentimi i rasteve të shkeljes së të drejtave dhe denoncimi i tyre pranë organeve kompetente.
- Stimulimi i një page që i përket standarteve më të cilat punojnë markat e prodhimit në Europë. Përdorja e një metodologjie të ngjashme me atë të përcaktimit të pagës në vendet e Europës për punonjësit e sektorit fason duke i'u përshtatur ekonomisë vendase.

Parajsa  
Fasonerike  
në Krizë!

## Referencat:

1. Fason.al, <https://fason.al/>
2. "BULETINI STATISTIKOR." AKPA, 2022, <https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Buletini-Statistikor-2021.pdf>.
3. "Fasoneria dhe puna jashtë vendit po sjellin të ardhura rekord për ekonominë shqiptare." *Revista Monitor*, 14 September 2022, <https://www.monitor.al/fasoneria-dhe-puna-jashte-vendit-po-sjellin-te-ardhura-rekord-per-ekonomine-shqiptare/>.
4. "Helmimi i punonjesve te fasonerise ne Durres, Policia jep detajet." CNA, [cna.al](https://www.cna.al/2022/03/28/helmimi-i-punonjeseve-te-fasonerise-ne-durres-policia-jep-detaje/), 28 March 2022, <https://www.cna.al/2022/03/28/helmimi-i-punonjeseve-te-fasonerise-ne-durres-policia-jep-detaje/>.
5. INSTAT. "INSTAT." *Databaza Statistikore*, [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START\\_DE/](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_DE/).
6. "Ministria e Financave dhe Ekonomise." *Ministria e Financave dhe Ekonomise*, 3 February 2022, <https://financa.gov.al/ministrja-ibrahimaj-ne-bilisht-respektimi-i-barabarte-i-ligjit-detyra-jone-paresore/>.
7. "Out now: First 2022 data on minimum wages in the EU." *European Commission*, 1 January 2022, <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/ddn-20220128-2>.
8. "REL: Bizneset në Shqipëri vuajnë për mijëra punëtorë." *Top Channel*, 31 October 2022, <https://top-channel.tv/2022/10/31/rel-bizneset-ne-shqiperi-vuajne-per-mijera-punetore/>.
9. "Statistika te Publikueshme." AKPA, 10 August 2022, <https://akpa.gov.al/statistika-te-publikueshme/>.
10. "Të punosh si kafshë", gratë e fasonerive që luftojnë për të drejtat e tyre." *AWEN NETWORK*, <https://awenetwork.org/te-punosh-si-kafshe-grate-e-fasonerive-qe-luftojne-per-te-drejtat-e-tyre/>.
11. "Top Channel/ Punëtorët e fasonerisë në Bilisht protestojnë kundër përgjysmimit të pagave." *YouTube*, 4 January 2023, <https://www.youtube.com/watch?v=51uMIGEtqPs>.
12. "U helmuan brenda fasonerisë në Durrës, punonjëset detyrohen të gënjejnë për kushtet." *Dritare.net*, <https://dritare.net/u-helmuan-brenda-fasonerise-ne-durres-punonjese-detyrohen-te-genjejne-per-kushtet>.



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)